INFRAKOS SH.A.
INFRAKOS D.D.
INFRAKOS J.S.C.
2
Nr No.Br. 2/88
Di 30.10.2026
Fushë Kosovë - Fushe Kosova - Kosovo Polje

INFRAKOS SH.A

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA /
REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA - VLADA - GOVERMENT
MINISTRIA E EKONOMISË
MINISTARSTVO EKONOMIJE
MINISTRY OF ECONOMY
Njësia Org. / Org. Jedin / Org Unit 011/3
Nr. Prot. / Br. Prot. / Prot.Nu 2105/2
Nr. / Broj / No. 1
Data / Datum / Date 03.11.26
PRISHTINË / PRIŠTINA

NDËRMARRJA PUBLIKE
INFRASTRUKTURA E HEKURUDHAVE TË KOSOVËS - INFRAKOS SH.A
Adresa: "Sheshi Lirisë" nr. 36 Fushë Kosovë tel. +383 38 550 550 500 www.infrakos.com

Në mbështetje të nenit 30, paragrafi 30.1, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-111 dhe Ligjin Nr. 05/L-009 për Ndërmarrjet Publike, ndërlidhur me nenin 26.15 të Kodit të Etikës për Qeverisjen Korporative, si dhe nenin 15 të Statutit të Ndërmarrjes Publike Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës - INFRAKOS SH.A., Bordi i Drejtorëve në mbledhjen e mbajtur më 29.10.2026, merr këtë:

V E N D I M

I. Miratohet Buxheti Vjetor i Ndërmarrjes Publike "Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës - Infrakos SH.A. për vitin 2027.

II. Obligohet Menaxhmenti i Ndërmarrjes që të ndërmarrin të gjitha hapat e nevojshme për të siguruar zbatimin strikt të buxhetit të miratuar, duke garantuar që shpenzimet e ndërmarrjes të mbeten brenda kufijve të lejuar dhe në përputhje me parimet e ekonomizimit, efikasitetit dhe Transparencës.

III. Obligohet Sekretari i ndërmarrjes që Buxhetin Vjetor për vitin 2027 sipas pikës I të këtij vendimi ta procedojë në NJPMNP-ME.

IV. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve.

INFRAKOS SH.A. · INFRAKOS D.D. · INFRAKOS J.S.C. · Fushë Kosovë

Z. Getuar Zogu

Kryesues i Bordit të Drejtorëve
N.P. Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës
INFRAKOS SH.A.

I dërgohet:

Bordit të Drejtorëve
Kryeshefit Ekzekutiv
Sekretarit
NJPMNP – ME
Arkivit të ndërmarrjes

INFRAKOS SH.A.
INFRAKOS D.D.
INFRAKOS J.S.C.
2
Nr.No.Br. 02/88-1
Dt. 30.10.2027
Fushe Kosove - Fushe Kosova - Kosovo Polje

NDËRMARRJA PUBLIKE
- INFRASTRUKTURA E HEKURUDHAVE TË KOSOVËS - INFRAKOS SH.A -
Adresa: "Sheshi Lirisë" nr. 36, Fushë Kosovës tel +383 38 550 550 500 www.infrakos.com

BUXHETI PËR VITIN 2027

I NDËRMARRJES PUBLIKE QENDRORE INFRASTRUKTURA HEKURUDHAVE TË KOSOVËS – INFRAKOS SH.A

Fushë Kosovë, 29/10/2026

Hyrje

Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës Sh.A. – INFRAKOS është themeluar në bazë të Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 05/110, të datës 26.02.2010, për ndarjen e Hekurudhave të Kosovës Sh.A. në dy shoqëri të reja: Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës Sh.A. – INFRAKOS dhe Operimi me Trena i Hekurudhave të Kosovës Sh.A. – TRAINKOS. INFRAKOS Sh.A. ushtron si veprimtari kryesore ofrimin e shërbimeve të infrastrukturës hekurudhore për operatorët e transportit hekurudhor, përfshirë NP TRAINKOS Sh.A. dhe operatorët privatë të transportit hekurudhor, ndërsa si shoqëri e veçantë ka filluar veprimtarinë më 01.09.2011. Si njëra ndër shoqëritë pasardhëse të Hekurudhave të Kosovës Sh.A., INFRAKOS Sh.A. është ndërmarrje publike në pronësi të Republikës së Kosovës dhe ushtron veprimtarinë e saj në territorin e Republikës së Kosovës. Shoqëria është e regjistruar në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës (ARBK) me Numër Unik Identifikues 811415620 dhe ka përgjegjësi për menaxhimin dhe mirëmbajtjen e një rrjeti të gjerë të infrastrukturës hekurudhore, i cili përfshin 333 km linja ekzistuese hekurudhore, 105 km linja në stacione dhe mbi 100 km linja industriale, si dhe sistemet e sinjalizimit, komunikimit dhe energjetikës. Në kuadër të këtij rrjeti përfshihen gjithashtu 32 stacione hekurudhore, 115 ura me gjatësi totale prej 2,988 metrash, 23 tunele me gjatësi totale prej 9,020 metrash, 759 lëshesa dhe 257 vendkalime në nivel, si dhe objekte të tjera infrastrukturore, ndërtesa dhe prona tokësore të shtrira në territorin e Republikës së Kosovës. Përmes menaxhimit dhe mirëmbajtjes së këtyre aseteve, INFRAKOS Sh.A. siguron funksionalitetin, sigurinë dhe qëndrueshmërinë e infrastrukturës hekurudhore dhe krijon kushtet e nevojshme për zhvillimin dhe operimin e transportit hekurudhor në Kosovë.



Përveç ofrimit të linjave hekurudhore në shërbim për operim dhe organizim të trafikut hekurudhor, biznesi i infrastrukturës hekurudhore ka të bëjë edhe me ndërtimin e binarëve industrial dhe infrastrukturës tjetër hekurudhore për nevoja të kompanive të ndryshme, si dhe dhënien me qira të pronës hekurudhore për përfitime komerciale.

PERMBLEDHJE HYRËSE EKZEKUTIVE

NP Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës – INFRAKOS Sh.A. synon zhvillimin dhe menaxhimin e një infrastrukture hekurudhore të sigurt, konkurruese dhe të qëndrueshme, duke ofruar shërbime efikase, transparente dhe jodiskriminuese për të gjithë operatorët e transportit. Misioni i Ndërmarrjes është krijimi dhe mirëmbajtja e një rrjeti funksional, në përputhje me nevojat e ekonomisë dhe shoqërisë, standardet e sigurisë, mbrojtjen e mjedisit dhe efikasitetin ekonomik. Objektivat e biznesit përcaktohen në bazë të analizave të të dhënave historike, zhvillimeve të tregut, kapaciteteve teknike dhe parametrave financiarë, duke synuar harmonizimin e nevojave operative dhe zhvillimore me burimet financiare dhe ruajtjen e likuiditetit. Përmes disiplinës buxhetore, kontrollit të shpenzimeve, shmangies së obligimeve pa mbulim financiar dhe mitjes së të hyrave vetanake, INFRAKOS Sh.A. synon të forcojë stabilitetin financiar, të përmirësojë performancën dhe të krijojë kushte për investime e zhvillim të mëtejmë të infrastrukturës hekurudhore, duke kontribuar në zhvillimin ekonomik të Kosovës dhe integrimin e sistemit hekurudhor në rrjetin rajonal të transportit.

BUXHETI OPERATIV I NP INFRAKOS SH.A

Buxheti operativ i Ndërmarrjes për vitin 2027 është planifikuar në bazë të kapaciteteve të saj për gjenerimin e të hyrave nga aktivitetet kryesore operative. Këto përfshijnë shfrytëzimin e kapaciteteve të infrastrukturës hekurudhore nga operatorët, dhënien me qira të pronës dhe aseteve të Ndërmarrjes, si dhe ofrimin e shërbimeve profesionale dhe teknike në ndërtimin, riparimin dhe mirëmbajtjen e linjave dhe binarëve industrialë.

Për vitin 2027, të hyrat operative planifikohen në shumën prej 4,013,800.00 €, me rritje prej 654,083.46 €, ose 19.47%, krahasuar me realizimin e vitit 2026, prej 3,359,716.54 €.
Shpenzimet operative planifikohen në shumën prej 3,892,703.00 €, me rritje prej 761,232.59 €, ose 24.31%, krahasuar me realizimin e vitit 2026, prej 3,131,470.41 €.

Bazuar në këto projeksione, për vitin 2027 planifikohet rezultat financiar pozitiv prej 121,097.00 €, që përfaqëson rreth 3.02% të të hyrave operative të planifikuara. Këto projeksione synojnë ruajtjen e qëndrueshmërisë financiare, kontrollin e shpenzimeve dhe përmirësimin e performancës operative të Ndërmarrjes.

STRUKTURA TË HYRAVE TË NDËRMARRJES

TË HYRAT NGA QASJA NË BINAR NGA OPERATORET TRANSPORTUES HEKURUDHOR

Të hyrat kryesore sipas veprimtarisë se biznesit të Infrakos-it me buxhetin për vitin 2027, parashihen të jetë nga shfrytëzimi i linjave hekurudhore nga operatori dhe atë në vlerë prej 264,000.00€ e që shprehur në përqindje do të jetë 50% me të larta se me buxhetin për vitin 2026. Kalkulimet për këtë kategori te të hyrave janë bërë bazuar në tarifat e aprovuara nga MIT, që ka diferenca me dokumentin e Ekspozesë se rrjetit të hartuar nga Infrakos SH.A, e cila diferencë me këtë buxhet është paraparë të mbulohet nga Qeveria e Kosovës përmes subvencionimit.
Realizimi i të hyrave nga transporti planifikohet të realizohet nga operatoret hekurudhor (Trainkos SH.A dhe Railtrans) të cilët operojnë në ketë fushë.
Struktura e këtyre të hyrave që prite të realizohet është:

- ***Të hyrat nga shfrytëzimi i rrjetit TM 90,000.00 €***
- ***Të hyrat nga shfrytëzimi i rrjetit TU: 174,000.00 €***

TË HYRAT NGA QIRAJA

Me buxhetin për vitin 2027, të hyrat nga këto kategori planifikohen në shumën prej **1,565,000.00 €**. Krahasuar me realizimin e vitit 2026, në shumën prej 1,555,554.71 €, këto të hyra janë më të larta për 9,445.29 €, ose 0.61%. Ndërsa, krahasuar me planifikimin e vitit 2026, në shumën prej 1,430,000.00 €, paraqesin rritje prej 135,000.00 €, ose 9.44%.

TË HYRAT NGA SHFRYTËZIMI I FIBRAVE (KABLLIT) OPTIK

Të hyrat nga shfrytëzimi i kabllit optik, në bazë të kontratës me PTK-në, planifikohen në shumën prej **296,640.00 €.**

TË HYRAT NGA QIRADHËNIA E PRONAVE

Të hyrat nga qiradhënia e pronave për vitin 2027 planifikohen në shumën prej **1,268,360 €.** Këto të hyra janë kalkuluar në bazë të të dhënave të sektorit të patundshmërisë dhe mbështeten në potencialin për dhënien me qira të objekteve dhe sipërfaqeve tokësore që Infrakos SH.A. i menaxhon përgjatë linjave hekurudhore.

TË HYRAT TJERA

Të hyrat tjera do të jenë **174,200.00€** me buxhetin për vitin 2027, krahasuar me buxhetin e rishikuar për vitin 2026 janë të njëjta. Struktura e të hyrave tjera qe priten të realizohen është:

- **Të hyrat nga shitja e materialeve/pajisjeve jashtë përdorimit: 90,000.00€**
- **Të hyrat tjera: 84,200.00€**

SUBVENCIONET NGA BUXHETI I KOSOVËS

Subvencionet nga BK-së për viti 2027 janë paraparë në shumë prej **1,300.000.00€** nga Ministria e Ekonomisë për mbulimin e kostove nga diferenca e qasjes në rrjet në përputhje me legjislacionin e aplikueshëm për Hekurudha.

TË HYRAT E SHTYRA (GRANTET NGA BK)

Të hyrat e shtyra janë kalkuluar në shumë prej **710,000.00€,** të hyra këto që nuk do ndikojnë në rezultat ngase tërë shuma trajtohet si shpenzime të zhvlerësimit.

STRUKTURA E SHPENZIMEVE TË NDËRMARRJES

Shpenzimet e planifikuara të Infrakos SH.A. për vitin 2027, sipas buxhetit të planifikuar, arrijnë shumën prej **3,892,703.00 €.** Krahasuar me shpenzimet e realizuara gjatë vitit 2026, në vlerë prej 3,131,470.00 €, shpenzimet e planifikuara për vitin 2027 janë më të larta për rreth 24.3%, përkatësisht për 761,233.00 €. Ndërsa, krahasuar me shpenzimet e planifikuara për vitin 2026, në vlerë prej 3,485,866.00 €, ato paraqesin një rritje prej rreth 11.7%, përkatësisht për 406,837.00 €

TABELA 1: TË HYRAT, SHPENZIMET DHE PLANIFIKIMET PËR VITIN 2027

Përshkrimi	Realizimi i parashikuar 2026	Buxheti 2027	Bordi & Kabineti i EE (Drejtuesi, MPM, IT)	Departamenti [illegible]	Departamenti [illegible]	Departamenti [illegible]
Të hyrat nga pagesat e qasjes në binarë	167,314.44	264,000.00	-	-	264,000.00	-
Të hyrat nga qiraja	1,555,554.71	1,565,600.00	-	1,565,600.00	-	-
Të hyrat tjera	218,252.77	174,200.00	-	-	174,200.00	-
Të hyrat e shtyra	704,173.81	710,000.00	-	-	710,000.00	-
Subvencionimi nga Qeveria	714,420.81	1,300,000.00	-	1,100,000.00	200,000.00	-

TOTALI I TE HYRAVE	3,359,716.54	4,013,800.00	-	2,620,000.00	1,348,200.00	-

Përshkrimi	Shpenzimet e planifikuara 2026 me revidim	Shpenzimet 2027	Bordi & Kabinetë i KE (Prokurim, MPAL, IT)	Dep. Sherbimeve të Korporatës	Dep. Teknik dhe i Komunikacionit	Dep. Financiar
Pajisjet	10,562.54	149,900.00	200.00	91,600.00	13,100.00	45,000.00
Hargj.e.lok. (ndertesave)	21,833.52	141,000.00	-	78,600.00	37,400.00	25,000.00
Energjia Elektrike	127,635.19	178,000.00	-	-	178,000.00	-
Nafta	28,141.34	36,900.00	-	-	36,900.00	-
Vajrat, lyerësit etj.	1,328.36	4,500.00	-	-	4,500.00	-
Materiali/hargj.operat	82,058.04	67,600.00	-	3,900.00	63,700.00	-
Riparimet	9,535.28	141,000.00	-	14,000.00	127,000.00	-
Shërbimet Operative	2,110.83		-	-	-	-
Udhëtimet zyrtare	2,078.13	13,025.00	11,285.00	240.00	1,500.00	-
Marke. dhe Publikimet	3,524.42	6,300.00	3,000.00	3,300.00	-	-
Shkollimi/Trajnim	2,500.00	5,000.00	1,000.00	4,000.00	-	-
Mat. i Zyrës dhe Konsum.	8,854.30	31,850.00	9,500	9,850.00	12,500.00	-
Telefoni dhe Mail/Internet	7,301.66	12,510.00	1,800.00	1,110.00	1,800.00	7,800.00
Detyrimet Kontingjente	128,805.71	178,000.00	-	178,000.00	-	-
Reprezentacion	6,099.76	5,220.00	3,780.00	480.00	480.00	480.00
Sigurimi	69,862.94	77,000.00	-	71,000.00	6,000.00	-
Stafi i jashtëm		3,000.00	-	3,000.00	-	-
Stafi dhe Punëtoret	1,819,591.77	2,042,500.00	-	2,042,500.00		-
Shpenzimet tjera operative	68,155.09	62,000.00	-	20,000.00	-	42,000.00
SHPENZIMET	2,399,978.58	3,153,305.00	30,565.00	2,521,580.00	482,880.00	120,280.00
Zhvlerësimi	727,576.33	730,000.00				
Provizione bankare	3,555.03	7,398.00				
Taksat	-					
TOTAL SHPENZIM	3,131,470.24	3,892,703.00				
REZULTATI NETO	228,264.13	121,097.00				

Tabela 2: Të hyrat dhe shpenzimet për vitit 2027, të krahasuara me buxhetin e vitit 2026.

Nr	Përshkrimi	Realizimi i parashikuar 2026	2026 Buxheti Planifikuar	2027 Buxheti Planifikuar
1	Gjithsejtë të hyrat	3,359,716.54	3,753,200.00	4,013,800.00
2	Gjithsejtë shpenzimet	3,131,470.41	3,485,866.00	3,892,703.00
Rezultati Neto		228,246.13	267,334.00	121,097.00

SHPENZIMET E NDËRMARRJES TË SPECIFIKUARA BRENDA KATEGORIVE/KODEVE BUXHETORE:

PAJISJET, MIRËMBAJTJA DHE PJESËT REZERVE:

Shpenzimet për këtë kategori planifikohen **149,900.00€,** sipas specifikimeve si në vijim:

- **Departamenti teknik dhe i komunikacionit:** ka parashikuar shumën prej **13,100€:** 1,500€ pajisjet për saldim; 1,500€ pajisje elektrike; 4,000€ pajisje radiolidhje/sinjalizim/telekomunikim, 2,000€ pajisje tjera për infrastrukturë hekurudhore, 500€ pajisje për zyre; 1,200€ pajisje/vegla pune.
- **Departamenti i shërbimeve të korporatës:** ka parashikuar shumën prej **91,600.00€:** 60,000€ furnizim me automjete; 1,910.00€ pajisje për zyre; 290.00 € pajisje tjera; 1,000 € pajisje/vegla pune; 1,900€ pajisje për pastrim; 25,000€ pajisje për punëtorë (rroba mbrojtëse dhe uniforma).
- **Departamenti i financave: ka planifikuar shumën prej 45,000 €** për softwer financiar.
- **Zyra për Marrëdhënie me Publikun:** zyra për marrëdhënie me publikun ka planifikuar shumën prej 200.00 € dhe atë: pajisje për zyre në vlerë prej 100.00€ për staf (tavolina dhe kërriga etj.) dhe pajisje tjera në shumën prej 100.00 €.

HARXHIMET E LOKALEVE (NDËRTESAVE):

Shpenzimet për këtë kategori planifikohen **141,000.00 €,** sipas specifikimeve si në vijim:

- **Departamenti teknik dhe i komunikacionit;** ka planifikuar shumën prej 37,400€: 35,000€ për rinovimin e sallës në ndërtesën e elektros që financohet nga granti i ME dhe 2,400.00€ shpenzime te qirasë për antenën e telekomunikimit.
- **Departamenti i shërbimeve të korporatës:** ka paraparë shumën prej 78,600.00€ dhe atë: 2,500€ shpenzime për mbeturin; 3,000 € riparimi i sistemit të ngrohjes, 1,000 €; riparime për kanalizim; 2,000€ material dhe pjesë për sistem të ujit; 3,100.00€ shpenzime publike për konsumim të ujit; 7,000€ riparime mirëmbajtëse të objekteve të Infrakos sipas rasteve dhe nevojave dhe 50,000€ për rregullimin e liftit në ndërtesën e elektros.
- **Departamenti Financave** ka parashikuar vlerën prej 25,000€, për vlerësimin e pasurisë se ndërmarrjes.

ENERGJIA ELEKTRIKE:

Kjo kategori e shpenzimeve me buxhetin e rishikuar për vitin 2027 është parashikuar shuma prej **178,000.00€.** Parashikimet janë bërë nga departamenti teknik dhe i komunikacionit, kryesisht për shpenzime të rrymës në rrjetin elektrik në stacione dhe linjat hekurudhore.

NAFTA, VAJRAT DHE LUBRIFIKANTET:

Shpenzimet për këtë kategori planifikohen **36,900 €** kryesisht për makineritë hekurudhore dhe automjete dhe vajrat në shumën prej **4,500 €.**

MATERIALI HARXHUES OPERATIV:

Shpenzimet për këtë kategori planifikohen **67,600 €,** sipas specifikimeve si në vijim:

- **Departamenti teknik dhe i komunikacionit;** i cili ka planifikuar **63,700 €,** që do të shpenzohen si ma poshtë; materiali elektrik 4,500 €; materiali për pastrim 1200 €; material për binarë (ballast dhe materiale të imta) 54,000.00 € që financohet nga gratet e ME; material për sinjalizim; 500 € materiale

për mjete lëvizëse)makineritë) dhe 1,500 € materiale tjera.

- **Departamenti i shërbimeve të korporatës;** ka planifikuar shumën prej **3,900 €** për këtë kategori të shpenzimeve dhe atë; material për pastrim higjenik 3,700 € dhe material medicinal për ndihma të para 1,200 €.

RIPARIMET:

Shpenzimet për këtë kategori planifikohen **141,000.00€,** sipas specifikimeve si në vijim:

- **Departamenti teknik dhe i komunikacionit;** ka planifikuar këto shpenzime në shumë prej **127,000€** dhe atë si ne vijim; riparimi kamionëve 500 €; riparim i binarëve 10,000 €; riparim makinave për binar (servisimi i thellë i makinës pllaser) 98,000 € që financohet nga grantet e ME; riparimi (pjesë rezervë) për sinjalizim, telekomunikacion 15,000 €; dhe riparimet tjera për kran, piruner dhe makineri tjetër 3,500 €.
- **Departamenti i shërbimeve të korporatës;** ka planifikuar këto shpenzime në shumën prej **14,000€** dhe atë si ne vijim; riparimin dhe mirëmbajtjen e veturave në shumë prej 9,000.00€: servisimi i aparateve kundër zjarrit dhe Deratizimi, Dezinfektimi dhe Dezinsektimi (DDD) objekteve në shumë prej 4,000.00 € dhe riparime tjera të pa percaktuara1,000 €.

MARKETINGU, PUBLIKIMET DHE TRAJNIME

Shpenzimet për këtë kategori planifikohen 6,300.00 € marketing dhe publikime dhe 5,000.00€ trajnime profesionale në këtë kategori me një total prej **11,300.00 €** sipas specifikimeve si në vijim:

- **Departamenti i shërbimeve të korporatës;** parashihen 7,300.00€ nga parashikimet janë si: publikimet në shtypin ditor për konkurse etj. 1,000.00 €; tjera 1,300.00€, dhënie 1,000.00 € dhe trajnime 4,000€
- **Zyra e KE dhe zyra për marrëdhënie me publikun:** parashihen shumën 4,000 € dhe atë sinë vijim : publikimet 1,500.00 €, te tjera 1,000.00 €, shtypja e reklamave 500.00 € dhe trajnime 1000 €.

MATERIAL I ZYRËS DHE KONSUMUES

Shpenzimet për këtë kategori planifikohen **31,850.00€,** sipas specifikimeve si në vijim:

- **Departamenti teknik dhe i komunikacionit:** ka parashikuar shumën prej **12,500 €,** dhe atë si në vijim; 1500€, konsumuese për zyre; 5,000 € pajisje/material për zyre (klima në stacione dhe zyre operative); 1,500 € shpenzimet për shtypje, 2,500 € shpenzimet për licencë dhe të tjera për raste të pa planifikuara 2000 €.
- **Departamenti i shërbimeve të korporatës:** ka parashikuar shumën prej **9,850.00€ €,** dhe atë si në vijim: material për zyre 6,000 €; artikuj të ndryshëm për zyre 500.00 €; konsumueset për kompjuterë 350.00€; shpenzimet për shtypje 2,500.00 €, shpenzimet te tjera 500 €.
- **IT;** parasheh **9,500.00€** dhe atë: 8,500 €, (mirëmbajtjes serverëve dhe fotokopjeve); konsumueset për kompjuterë 500 €; pajiset kompjuterike 500 €.

TELEFONIA, POSTA DHE INTERNET:

Shpenzimet për këtë kategori planifikohen **12,510.00 €,** sipas specifikimeve i në vijim:

- **Departamenti Teknik dhe i Komunikacionit** ka parashikuar shumën prej **1,800 €,** dhe atë e terë shuma për shpenzimet e telefonisë fikse.
- **Departamenti i shërbimeve të korporatës** ka parashikuar shumen prej **1,110 €** dhe atë e terë shuma për shpenzimet e posta dhe dërgesave.
- **Departamenti i financave** ka parashikuar shumen prej **7,800.00 €** dhe atë e terë shuma për shpenzimet e telefonisë mobile-mbushje.
- **IT,** ka parashikuar shumen prej **1,800 €** dhe atë e tërë shuma për shpenzimet e shërbimeve te internetit.

SHPENZIMET E JASHTËZAKONSHME / RREZIKSHMËRISË:

Shpenzimet për këtë kategori planifikohen **178,000.00€** sipas specifikimeve si në vijmë: pagesa taksave gjyqësore prej 10,000€ dhe shpenzimet për kompensimi sipas aktgjykimeve gjyqësore në shumë prej 168,000

€. me ketë kategori planifikohen te mbulohen shpenzimet lidhur me taksat gjyqësore/përmbarimore për rastet e iniciuara nga Infrakos dhe detyrimet eventuale nga kontestet e humbura ligjore.

SIGURIMI

Shpenzimet për këtë kategori planifikohen **77,000 €,** sipas specifikimeve si në vijim:

- **Departamenti teknik dhe i komunikacionit** ka planifikuar vlerën prej 6,000.00€ për sigurim të palëve të treta.
- **Departamenti i shërbimeve të korporatës** ka planifikuar shumën prej 71,000.00 €, dhe atë si në vijim; sigurim të veturave zyrtare në vlerë prej 3,500.00 €: sigurimi shëndetësor 62,000.00 € dhe shpenzime mjekësore 1,000.00 €, tjera – vlerësimi riskut nga vendet e punës 4,500.00 €.

SHPENZIMET E PERSONELIT-STAFIT

Shpenzimet për këtë kategori planifikohen **2,042,500.00 €, ku** përfshihen shpenzimet për pagat e stafit, kontributet pensionale, pensionimi dhe kompensime tjera që ndërlidhen me marrëdhënien e punës dhe punësime sipas nevojave të ndërmarrjes.

SHPENZIMET TJETRA OPERATIVE

Shpenzimet për këtë kategori planifikohen **62,000.00 €,** sipas specifikimeve si në vijim:

- **Departamenti i shërbimeve të korporatës** ka parashikuar shumën prej 20,000.00 € dhe atë: shpenzime për tatime komunale në pronë prej 19,000.00 € dhe 1,000.00 € për raste të jashtëzakonshme.
- **Departamenti i financave** ka parashikuar shumën prej 42,000 € dhe atë si ne vijim: shpenzime për provizionin e borxheve të këqija 35,000 € dhe auditimin e pasqyrave financiare të vitit 2026 në vlerë prej 7,000.00 €.

PËRFUNDIMI DHE PËRMBYLLJA EKZEKUTIVE

NP Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës – INFRAKOS Sh.A. ka përgatitur Buxhetin për vitin 2027 në përputhje me objektivat dhe prioritetet e përcaktuara në Planin e Biznesit për vitin 2027, si dhe duke marrë në konsideratë kuadrin ekonomik, financiar dhe operacional në të cilin zhvillohet veprimtaria e Ndërmarrjes. Buxheti i vitit 2027 përfaqëson një instrument të rëndësishëm të planifikimit dhe menaxhimit financiar, të orientuar drejt sigurimit të qëndrueshmërisë financiare, ruajtjes së likuiditetit, disiplinës buxhetore dhe përdorimit racional e efektiv të burimeve. Planifikimi është mbështetur në parimet e prudencës financiare dhe të kontrollit të kostove, me synim harmonizimin e të hyrave të pritshme me shpenzimet e planifikuara dhe detyrimet e

Ndërmarrjes. Bazuar në projeksionet financiare për vitin 2027, INFRAKOS Sh.A. planifikon të realizojë të hyra në shumën prej **4,013,800.00€,** ndërsa shpenzimet e planifikuara paraqesin shumën prej **3,892,703.00€,** duke rezultuar në një rezultat financiar pozitiv prej **121,097.00 €.** Ky rezultat pasqyron një qasje të kujdesshme dhe të disiplinuar ndaj menaxhimit financiar, me fokus në ruajtjen e likuiditetit, optimizimin e burimeve dhe forcimin e kapacitetit financiar të Ndërmarrjes për përmbushjen e detyrimeve dhe realizimin e objektivave të saj strategjike dhe operacionale.

Buxheti i vitit 2027 paraqet një **kornizë të qëndrueshme dhe të matur të menaxhimit financiar,** që synon të sigurojë vazhdimësinë e veprimtarisë, stabilitetin financiar dhe përmirësimin e performancës së përgjithshme të INFRAKOS Sh.A. Realizimi i objektivave buxhetore do të mbështetet përmes monitorimit të vazhdueshëm të performancës financiare, kontrollit të devijimeve dhe ndërmarrjes në kohë për masa korrigjuese. Në këtë kuadër, Buxheti i vitit 2027 krijon një bazë të përgjegjshme dhe të qëndrueshme për **konsolidimin financiar, forcimin e kapacitetit operacional dhe zhvillimin e mëtejmë të INFRAKOS SH.A.**

Aprovuar nga Bordi i Drejtorëve të NP. Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës - INFRAKOS SH.A me datë 29.10.2026.